



Dalës-Izlazna

Nr. -1-107
Br. _____

Data 04. 08. 2023
Datum _____

OBILIQ

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIĆ



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) dhe nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016, si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës nga Këshilltarët e Kuvendit Komunal, nr.-I-20022/23 të dt.01.08.2023, Kuvendi komunal në mbledhjen e jashtëzakonshme me dt. 04.08.2023, mori këtë:

V E N D I M
P Ë R

1. Formimin e komisionit në përbërje, si vijon:
 1. Jeton Mjekiqi- Kryetar i komisionit (IQO),
 2. Sami Ahmeti- anëtar i komisionit (VV),
 3. Xhelal Krasniqi- anëtar i komisionit (AAK),
 4. Berat Mehmeti-anëtar i komisionit, Zyrtar Ligjor,
 5. Afrim Mexhani- anëtar i komisionit, përfaqësues i fshatit Siboc.
2. Komisioni ka për detyrë të shqyrtoj të gjithë dokumentacionin lidhur me shpronësimin e pronave të pronarëve fizik (banorëve nga fshati Siboc, konkretisht lagjet Mexhuani dhe Kongjeli) nga KEK-u dhe Qeveria.
3. Komisioni do të kontaktojë me përfaqësuesit e Ministrisë të linjave, KEK-un dhe qytetarët e këtyre lagjeve, lidhur me shpronësimet e zhvlersuara nga KEK-u dhe Qeveria të qytetarëve në fshatin Siboc.
4. Komisioni për punën e tij do të përgadis raport me shkrim me të cilin do të njoftojë Kuvendin Komunal.
5. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

-T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- Anetareve te Komisionit
- DAP
- MAPL
- Arkivit

